



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA GRAMSH
KËSHILLI I BASHKISË

Nr. 4764/2 Prot

Gramsh më 26/07/2018

VENDIM
NR 56 DATË 24/07/2018
PËR

SHPRONËSIMIN ,PËR INTERES PUBLIK,TË PRONARËVE TË PASURIVE TË
PALUAJTSHME ,PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA REALIZIMI I PROJEKTIT
“RIKONSTRUKSION I RRUGËS SE FSHATIT DUMBERAS,NJËSIA ADMINISTRATIVE
KUSHOVË ”

Në zbatim të ligjit nr. 8651 datë 22.12.1999”Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë ,pronë private ,për interes publik”,VKM nr.127 datë 23.03.2000”Për përmbajtjen dhe procedurat e paraqitjes së kërkesës dhe të njoftimit për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik”,VKM nr.138 datë 23.03.2000”Për kriteret teknike të vlerësimit dhe të përlllogaritjes së masës së shpërblimit të pasurive të pronë private që shpronësohen ,të pasurive që zhvlerësohen dhe të dtejtave të peronave të tretë ,për intëres publik”,VKM nr.89 datë 03.02.2016 “Për miratimin e Hartës së Vlerës së Tokës në Republikën e Shqipërisë”, si dhe ligjit Nr.139/2015 ,datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”neni 8,pika 2 ; neni 9 pika i.2 gërma “b”si dhe neni 54, Këshilli i Bashkisë :

V E N D O S I

1. Të miratojë shpronësimin për interes publik të pronarit të pasurive të paluajtshme ,pronë private që preken nga realizimi i projektit “Rikonstruksion i rrugës së fshatit Dumberas,Njësia Administrative Kushovë”.
2. Shpronësimi të bëhet në favor të bashkisë Gramsh.
 - Pronari i pasurisë së paluajtshme që shpronësohet,të kompensohet në vlerë te plotë ,sipas masës së vlerësimit,për pasuritë ”tokë arë” me një vlerë të përgjithshme prej 156 600 (njëqind e pesëdhjetë e gjashtë mijë e gjashtëqind) lekë,si më poshtë:
 - Z.Misir Zani, Fshati Kushovë, ZK 2347,nr.pasurisë 5/7/1,sip.900 m2(toke arë) , me vlerësim në vlerën 156 600 (njëqind e pesëdhjetë e gjashtë mijë e gjashtëqind) lekë.
3. Vlera e përgjithshme e shpronësimit të përballohet nga buxheti i bashkisë i miratuar për vitin 2018.
4. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet administrata e bashkisë.
5. Ky vendim hyn ne fuqi 10 dite pas shpalljes.

SEKRETARI I KËSHILLIT
Astrit DUZHA

Konceptoi .A.Duzha
Pranoi
Miratoi Sh.Hoxha
Dosja nr. _____
Afati _____



KRYETARI I KËSHILLIT
Shkëlqim HOXHA